



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-026

PËR MARKAT TREGTARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJIN PËR MARKAT TREGTARE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për subjektet që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit për fitimin e markës tregtare në Zyrën për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës e themeluar në Ministrinë e

Tregtisë dhe Industrisë (në tekstin e mëtejshëm Zyra) përfshirë markat komunitare dhe regjistrimet ndërkombëtare të markës tregtare që vlejnë në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria e tregtisë dhe industrisë;

1.2. **Ministër** – Ministri i tregtisë dhe industrisë;

1.3. **Zyra** - Zyra e pavarur për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës e themeluar në Ministrinë e tregtisë dhe industrisë;

1.4. **Konventa e Parisit** - Konventa për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale e datës 20 mars 1883 e rishikuar dhe e ndryshuar;

1.5. **Markat tregtare të njohura** - Marka tregtare sipas nenit 6bis të Konventës së Parisit;

1.6. **Klasifikimi i Nicës** - Klasifikimi ndërkombëtar i mallrave dhe shërbimeve i miratuar me Marrëveshjen e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të regjistrimit të markës e datës 15 qershor 1957, e rishikuar dhe ndryshuar;

1.7. **Marrëveshja e Madridit** - Marrëveshja e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave, e arritur me 14 prill 1891, e rishikuar dhe e ndryshuar;

1.8. **Protokolli i Madridit** - Protokolli për Marrëveshjen e Madridit për regjistrimet ndërkombëtare të markave e arritur me 27 qershor 1989 në Madrid;

1.9. **Rregullat e përbashkëta** - Rregullat e përbashkëta sipas Marrëveshjes së Madridit lidhur me regjistrimin ndërkombëtar të markave dhe Protokollin lidhur me këtë Marrëveshje;

1.10. **WIPO/OBPI** - Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale e themeluar me Konventën e WIPO-s;

1.11. **Byroja Ndërkombëtare** - Sekretariati i WIPO-s;

1.12. **Gazeta e WIPO-s** - gazeta zyrtare e regjistrimeve ndërkombëtare e publikuar nga Byroja Ndërkombëtare;

1.13. **Rregullorja për markat tregtare komunitare** - Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 207/2009 për markat tregtare komunitare e datës 26 shkurt 2009;

1.14. **Markë tregtare komunitare** - marka tregtare e përkufizuar në paragrafin 1. të nenit 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 207/2009 për markat tregtare komunitare e datës 26 shkurt 2009;

1.15. **Aplikimi për markë tregtare komunitare** - aplikimi për regjistrimin e markës tregtare komunitare;

1.16. **Markë tregtare kombëtare** - marka tregtare e fituar në procedurën para Zyrës në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

1.17 **Aplikimi kombëtar për markë tregtare** – aplikimi për markë tregtare të paraqitur në Zyrë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

1.18 **Subjekt** – personi fizik ose juridik

1.19. **Licenca ekskluzive** – licenca kur jepet nga pronari i markës tregtare dhe me te barten te drejtat ekskluzive te markës;

1.20. **Licenca joeksluzive** – licenca kur jepet nga pronari i markës tregtare dhe barten vetëm te drejtat e përcaktuara nga pronari i markës.

Neni 4

Fitimi i të drejtës për markë tregtare

1. E drejta për markë tregtare fitohet përmes regjistrimit në regjistrin e markave tregtare që udhëheq Zyra për Pronësi Industriale.
2. Subjekti vendas dhe i huaj mund të jetë pronar të markës tregtare në Republikën e Kosovës.
3. Subjekti që nuk është shtetas i Republikës së Kosovës apo nuk ka seli të regjistruar të biznesit paraqitet në Zyrë vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar.

Neni 5

Shenjat që mund të mbrohen si markë tregtare

Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë e cila mund të paraqitet grafikisht, në veçanti fjalët, përfshirë edhe emrat personal, skicimet, shkronjat, numrat, formën e mallrave apo paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimi i gjitha këtyre me kusht që shenjat e tilla të mund të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera.

Neni 6

Refuzimi për shkaqe absolute

1. Si markë tregtare nuk mund të regjistrohen apo nëse janë regjistruar, duhet të shpallen të pavlefshme:

1.1. shenjat që nuk janë në përputhje me nenin 5 të këtij ligji;

1.2. markat tregtare që nuk përmbajnë ndonjë veçori dalluese;

1.3. markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht shenja ose tregues që mund të përdoren në tregti për të përcaktuar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, prejardhjen gjeografike, kohën e prodhimit të mallrave ose të kryerjes së shërbimeve ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave dhe shërbimeve;

1.4. markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues të cilat janë bërë të zakonshme në gjuhën e përditshme ose që përdoret në mirëbesim si dhe që janë kthyer në praktika të zakonshme tregtare;

1.5. shenjat të cilat përbëhen ekskluzivisht prej:

1.5.1. trajtës e cila rezulton nga vetë natyra e mallrave;

1.5.2. trajtës së mallrave e cila është e nevojshme për të fituar një rezultat teknik;

1.5.3. trajtës e cila u jep mallrave një vlerë substancial;

1.6. markat tregtare që janë në kundërshtim me parimet e moralit dhe rendin publik;

1.7. markat tregtare që mund të mashtrojnë publikun, për shembull përkitazi me natyrën, cilësinë apo prejardhjen gjeografike të mallrave ose shërbimeve;

1.8. markat tregtare që nuk janë autorizuar nga autoritetet kompetente në pajtim me nenin 6 të Konventës së Parisit.

1.9. markat tregtare përdorimi i të cilave mund të jetë i ndaluar me dispozitat e ndonjë ligji tjetër;

1.10. markat tregtare të cilat përmbajnë simbole, emblema dhe stema shtetërore që nuk janë përcaktuar në nenin 6 të Konventës së Parisit dhe që janë në interesin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përveç në rastet kur regjistrimi i tyre lejohet nga organi kompetent;

1.11. markat tregtare për verëra ose pije alkoolike që përmbajnë apo përbëhen nga një tregues gjeografik që i identifikon verërat apo pijet alkoolike që nuk kanë atë prejardhje;

1.12. markat tregtare që përmbajnë ose përbëhen nga një emërtim i origjinës apo tregues gjeografik me efekt në territorin e Republikës së Kosovës, nëse aplikimi për regjistrimin e markës tregtare është bërë pas aplikimit për regjistrimin e një emërtimi të origjinës apo treguesi gjeografik dhe është në kërkesën për regjistrimin e treguesit gjeografik, të përcaktuar më legjislacionin përkatës bazën e të cilit emërtimet e tilla janë regjistruar për llojin e njëjtë të mallrave.

2. Nën-paragrafët 1.2., 1.3. dhe 1.4. të këtij neni nuk zbatohen nëse në procesin e përdorimit përpara datës së aplikimit për regjistrim marka ka fituar karakter dallues përkitazi me mallrat ose shërbimet për të cilat kërkohet regjistrimi.

Neni 7

Refuzimi për shkaqe relative

1. Me rastin e paraqitjes së kundërshtimit nga pronari i markës së mëhershme, marka tregtare për të cilën është paraqitur aplikimi nuk regjistrohet nëse:

1.1. është identike me markën e mëhershme dhe mallrat ose shërbimet për të cilat paraqitet aplikimi, janë identike me mallrat ose shërbimet e mbrojtura me markën e mëhershme;

1.2. është identike ose e ngjashme me markën e mëhershme dhe mallrat ose shërbimet për të cilat paraqitet aplikimi, janë të ngjashme me mallrat ose shërbimet të cilat mbrohen nga marka e mëhershme tregtare dhe kur për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shaktimit të konfuzionit të publiku ku përfshihet edhe mundësia e asociimit me markën e mëhershme.

2. „Markë e mëhershme tregtare“, në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni, nënkuptohet:

2.1. marka e regjistruar me një datë aplikimi apo datë të përparësisë më të hershme;

2.2. aplikimi për regjistrim të një marke, me një datë aplikimi ose datë të përparësisë më të hershme, në procedurë të regjistrimit;

2.3. marka e cila në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e përparësisë, është e mirënjohur në Republikën e Kosovës;

2.4. marka tregtare komunitare ose aplikimi për regjistrimin e markës tregtare komunitare, sic është përcaktuar në paragrafin 1. të nenit 83 të këtij ligji.

2.5. markat regjistruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë efekt në Republikën e Kosovës;

3. Me rastin e paraqitjes së kundërshtimit nga pronari i markës së mëhershme, sipas paragrafit 2. të këtij neni nuk do të regjistrohet marka që është identike ose e ngjashme me markën e mëhershme tregtare, e cila mbrohet për mallra ose shërbime që janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, nëse marka e mëhershme ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet karakteri dalluese i markës së mëhershme.

4. Me rastin e paraqitjes së kundërshtimit nga pronari i markës së mëhershme, marka nuk regjistrohet nëse përfaqësuesi i pronarit të markës tregtare pa autorizimin e pronarit aplikon për regjistrimin e markës tregtare në emrin e vet, përveç në rastet kur përfaqësuesi arsyetohet veprimet e tij.

KREU II

EFEKTET E MARKËS TREGTARE

Neni 8

Të drejtat e fituara nga marka tregtare

1. Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij:

1.1. çdo shenjë, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare;

1.2. çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asociimit së shenjës me markën tregtare;

1.3. çdo shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare për produktet dhe shërbime të ndryshme nga ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, kur kjo e fundit ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri te njohur te markës.

2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime:

2.1. vendosja e shenjës në mallra apo në paketimet e tyre;

2.2. hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje dhe ofrimi i shërbimeve duke përdorur këtë shenjë, ose magazinimi i tyre për këto qëllime;

2.3. përdorimi i shenjës gjatë importimit apo eksportimit të mallrave;

2.4. përdorimi i shenjës në shkresa zyrtare dhe në reklamim.

3. Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës kanë efekt mbi palët e treta që nga data e publikimit të regjistrimit të markës tregtare. Mund të kërkohej kompensim për shkeljen e markës që ndodhin pas datës së publikimit të aplikimit të markës tregtare, shkeljet të cilat pas publikimit të regjistrimit të markës tregtare duhet të ndalohen. Gjykata që ka në shqyrtim çështjen nuk mund të vendosë për këtë çështje derisa të publikohet regjistrimi.

Neni 9

Citimi i markave tregtare në fjalor

Nëse marka e regjistruar tregtare është cekur në fjalor, enciklopedi apo material të ngjashëm që shërben si referencë dhe jep përshtypjen se ajo përbën emër gjenerik të mallrave ose shërbimeve për të cilat është regjistruar marka tregtare, duke përfshirë ato në formë elektronike, botuesi me kërkesë të pronarit të markës tregtare në botimin e ardhshëm të publikimit, me një reference tregon se ajo markë është e regjistruar.

Neni 10

Markat tregtare të regjistruara në emër të përfaqësuesit tregtar

Kur marka tregtare është regjistruar në emër të përfaqësuesit tregtar pa autorizimin e pronarit të markës tregtare, pronari ka të drejtë ta kundërshtojë përdorimin e asaj marke nëse ai nuk e ka autorizuar një veprim të tillë, përveç nëse përfaqësuesi e arsyeton veprimin e tij.

Neni 11

Kufizimi i efekteve të markës tregtare

1. Pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë një palë të tretë që në veprimtarinë e tij afariste të përdorë:

1.1. emrin ose adresën e tij;

1.2. të dhënat për llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, prejardhjen gjeografike, kohën e prodhimit të produkteve ose kohën e shërbimeve të ofruara, apo karakteristika të tjera të mallrave ose shërbimeve;

1.3. markën, kur ajo është e nevojshme për të treguar qëllimin e përdorimit të mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht në rastin e pajisjeve shtesë apo pjesëve rezervë me kusht që ato përdoren në pajtim me praktikën e ndërshtesë industriale ose tregtare.

Neni 12

Humbja e të drejtave të fituara nga marka tregtare

1. Humbja e të drejtës për ndalimin e përdorimit të markës për produkte dhe shërbime fillon me futjen e markës në tregun e Republikës së Kosovës nga ana e vet pronarit ose pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shteteve që janë palë në Marrëveshjen që krijon Zonën Ekonomike Evropiane, me atë markë tregtare.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet në rastin kur pronari i markës së regjistruar tregtare kundërshton përdorimin e mëtejshëm të markës tregtare duke dëshmuar se cilësia e mallrave ka ndryshuar apo është dëmtuar pas hedhjes së tyre në treg.

Neni 13

Kufizimi i efekteve si pasojë e tolerimit

1. Kur pronari i markës së mëhershme tregtare ka toleruar pa kundërshtim për një periudhë të pandërprerë pesë (5) vjeçare, përdorimin e një marke të regjistruar më vonë në Republikën e Kosovës, duke qenë në dijeni të përdorimit të saj, ai humb të drejtën që në bazë të markës së mëhershme tregtare të kërkojë shpalljen e markës së mëvonshme tregtare të pavlefshme ose ta kundërshtojë përdorimin e markës së mëvonshme për mallrat ose shërbimet për të cilat marka e mëvonshme është përdorur, përveç kur regjistrimi i markës së mëvonshme nuk është bërë në keqbesim.

2. Paragrafi 1. i këtij neni gjithashtu zbatohet për pronarët e markës së mëhershme tregtare të përmendur në paragrafin 3. të nenit 7 të këtij ligji apo të një të drejte të mëhershme të përmendur në nën-paragrafët 1.5. ose 1.6. të nenit 52 të këtij ligji.

3. Në rastet si në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, pronari i markës tregtare të regjistruar më vonë nuk ka të drejtë që të kundërshtojë përdorimin e të drejtës së markës së mëhershme, edhe pse ajo e drejtë mund të mos vihet në përdorim kundër markës së mëvonshme tregtare.

4. Bartësi i markës së mëvonshme të regjistruar nuk ka të drejtë që ta kundërshtojë përdorimin e të drejtës së mëhershme edhe pse bartësi i të drejtës së mëhershme në atë të drejtë nuk mundet të thirret kundër markës së mëvonshme.

KREU III PËRDORIMI I MARKËS TREGTARE

Neni 14 Përdorimi i markës

1. Pronari i markës tregtare ka të drejtën e përdorimit të markës së tij për mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar.

2. Përdorimi i markës tregtare, sipas paragrafit 1. të këtij neni, gjithashtu, nënkupton:

2.1. përdorimin e markës në një formë që nuk dëmton karakterin dallues të saj në formën që ajo është regjistruar;

2.2. përdorimin e markës tregtare në mënyrë që dallon në elementet që nuk e ndryshojnë veçorinë dalluese të markës tregtare në formën në të cilën është regjistruar;

2.3. vendosjen e markës në mallrat apo paketimet e tyre në Republikën e Kosovës vetëm për qëllime eksporti.

3. Përdorimi i markës me pëlqimin e pronarit apo të ndonjë personi që ka autorizimin për përdorimin e markës kolektive apo certifikuese kuptohet si përdorim nga ana e pronarit.

4. Nëse brenda një periudhe pesë (5) vjeçare nga data e përfundimit të procedurës së regjistrimit, pronari i markës nuk e ka përdorur atë në Republikën e Kosovës, për mallrat ose shërbimet për të cilat marka është regjistruar, apo nëse përdorimi i markës është pezulluar për një periudhë pandërprerët pesë (5) vjeçare, marka bëhet subjekt i sanksioneve të parashikuara me këtë ligj, përveç kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin e saj.

KREU IV MARKA TREGTARE SI OBJEKT I PRONËSËSISË

Neni 15 Bartja e të drejtës

1. Marka tregtare mund të bartet ndaras nga ndonjë transferim i ndërmarrjes lidhur me disa apo të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar.

2. Në rastin e bartjes të markës tregtare për disa prej mallrave dhe shërbimeve për të cilat është regjistruar marka tregtare, duke bërë ndarjen e regjistrimit apo aplikimit të markës tregtare sipas nenit 39 dhe 44 të këtij ligji.

3. Me kërkesë të njëjës prej palëve bartja shënohet në Regjistrin e Markave Tregtare me kusht që të ofrohen dëshmi të mjaftueshme për bartje si: kopja e vërtetuar e kontratës së bartjes apo pjesa e vërtetuar e asaj kontrate e nënshkruar nga të dyja palët apo aktgjykimi i dhënë për atë çështje, t'i parashtrohen Zyrës dhe të jetë paguar tarifa e paraparë për regjistrimin e bartjes në Regjistrin e Markave Tregtare.

4. Bartja e markës tregtare publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

5. Kërkesa për regjistrimin e bartjes në regjistër duhet të paraqitet sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me aktet nënligjore sipas këtij ligji.

6. Përderisa bartja nuk është regjistruar në Regjistrin e Markave Tregtare, përfituesi i të drejtës nuk mund t'i përdor të drejtat e fituara nga regjistrimi i markës tregtare.

7. Dokumentet për të cilat kërkohet të njoftohet pronari i markës tregtare do t'i adresohen personit të regjistruar si bartës i së drejtës.

Neni 16

Bartja e markës tregtare të regjistruar në emër të përfaqësuesit

Kur marka tregtare është regjistruar në emër të një përfaqësuesi pa autorizimin e subjektit i cili është pronar i markës tregtare, ky i fundit ka të drejtë të kërkojë që regjistrimi (marka tregtare) i bërë të kalojë në favor të tij, përveç nëse përfaqësuesi e arsyeton veprimin e tij.

Neni 17

Licencimi

1 Licenca për përdorimin e markës tregtare mund të jepet për disa apo për të gjitha mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar, për tërë apo një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Licenca mund të jetë ekskluzive dhe jo ekskluzive.

2. Pronari i markës tregtare mund shfrytëzojë të drejtat e fituara me regjistrimin e markës tregtare kundër një personi të pajisur me licencë, i cili shkel ndonjë dispozitë të kontratës së tij të licencimit lidhur me kohëzgjatjen, fushën e mbuluar me regjistrimi për të cilën marka tregtare mund të përdoret, gamën e mallrave apo shërbimeve për të cilat është dhënë licenca, territorin në të cilin marka tregtare mund të përdoret apo cilësinë e produkteve të prodhuara ose shërbimeve të ofruara nga personi i pajisur me licencë.

3. Me kërkesë të njëjës prej palëve licenca shënohet në Regjistrin e Markave Tregtare me kusht që të ofrohen dëshmi për licence si: kopja e certifikuar e marrëveshjes për licencim, pjesa e certifikuar e asaj marrëveshjeje apo certifikata origjinale për dhënien e licencës e bërë me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët i parashtrohen Zyrës dhe të jetë paguar tarifa e paraparë për regjistrimin e licencës në Regjistrin e Markave Tregtare.

4. Licenca e markës tregtare publikohet në buletin zyrtarë të Zyrës.
5. Kërkesa për regjistrimin e licencës në Regjistrin e Markave Tregtare duhet të bëhet sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me akte nënligjore të miratuara nga Ministri.

Neni 18

Të drejtat e pengut

1. Marka tregtare pavarësisht nga ndërmarrjet, sigurohet ose mund të jetë objekt i pengut.
2. Pengu regjistrohet në Regjistrin e Markave Tregtare me kërkesë të njëjës nga palët dhe publikohet në buletin zyrtarë të Zyrës.
3. Kërkesa për regjistrimin e pengut në Regjistrin e Markave Tregtare duhet të bëhet sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me akte nënligjore të miratuara nga Ministri.

Neni 19

Marka tregtare si objekt i përmbarimit

1. Marka tregtare mund të jetë objekt i përmbarimit.
2. Gjykata që ndërmerr dhe shqipton masa përmbaruese sipas detyrës zyrtare informon Zyrën për masën përmbaruese të ndërmarrë apo shqiptuar kundër markës tregtare me qëllim të regjistrimit të procedurës së përmbarimit në Regjistrin e Markave Tregtare.
3. Masa e ndërmarrë apo shqiptuar e përmbarimit kundër markës tregtare të regjistruar në Regjistrin e Markave Tregtare publikohet në Buletin Zyrtarë të Zyrës.
4. Kërkesa për regjistrimin e masës së përmbarimit në regjistrin e markave tregtare duhet të paraqitet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor.

Neni 20

Falimentimi

1. Kur pronari i markës tregtare është përfshirë në falimentim apo në procedura të ngjashme, me kërkesë të autoritetit kompetent shënohet në Regjistrin e Markave Tregtare dhe publikohet në buletin zyrtarë të Zyrës.
2. Kërkesa për regjistrimin e falimentimit ose procedurave të ngjashme në të cilat është përfshirë marka tregtare në regjistër duhet të paraqitet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor.

Neni 21
Efektet lidhur me palët e treta

1. Dispozitat ligjore të cekura në nenet 15, 17 dhe 18 të këtij ligji zbatohen ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit në Regjistrin e Markave Tregtare. Megjithatë një akt i tillë zbatohet ndaj palëve të treta edhe përpara se e drejta e fituar nga marka tregtare të jetë regjistruar në regjistër, nëse dëshmohet se pala e tretë ishte në dijeni të ekzistimit të një akti të tillë.
2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet në rastin kur një subjekti fiton markën tregtare ose të drejtën lidhur me markën tregtare përmes bartjes së tërë ndërmarrjes apo përmes trashëgimisë.

Neni 22
Aplikimi për regjistrim të markës tregtare si objekt i pronës

Nenet 15 deri 21 të këtij ligji duhet të zbatohen njëjtë sikur në procedurën për aplikim për regjistrim të markave tregtare.

KREU V
APLIKIMI PËR MARKË TREGTARE

Neni 23
Aplikimi për markë tregtare

1. Procedura për regjistrim të Markës tregtare fillon me paraqitjen e aplikacionit në zyre.
2. Aplikacioni për regjistrim mund të jetë vetëm për një shenjë për të cilën kërkohet mbrojtja.

Neni 24
Kushtet e aplikimit për markë tregtare

1. Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare duhet të përmbajë:
 - 1.1. kërkesën për regjistrimin të markës tregtare;
 - 1.2. të dhënat për paraqitësin;
 - 1.3. listën e mallrave apo shërbimeve për të cilat kërkohet regjistrimi;
 - 1.4. dukjen e markës tregtare.

2. Aplikimi për regjistrimin e markës tregtare i nënshtrohet pagesës së tarifës të përcaktuar me akt nënligjor.

3. Aplikimi për regjistrimin e markës tregtare duhet të plotësoj kushtet të përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni dhe kushtet tjera të përcaktuara me akt nënligjor.

Neni 25 **Data e paraqitjes së aplikimit**

Data e paraqitjes së aplikimit për regjistrimin e markës tregtare është data e pranimit të aplikacionit në zyra. Nëse disa dokumente janë parashtruar me data të ndryshme si datë e paraqitjes konsiderohet data në të cilin është pranuar dokumenti i fundit për plotësimin e kushteve sipas neni 24 paragrafit 1. të këtij ligji në zyrë.

Neni 26 **Klasifikimi**

Mallrat dhe shërbimet për të cilat paraqitet aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare klasifikohen sipas klasave të Klasifikimi i Nicës.

Neni 27 **E drejta e përparësisë e fituar me aplikim**

1. Aplikuesi nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim të markës tregtare ka përparësi ndaj çdo aplikues tjetër që paraqet aplikim për regjistrimin e markës tregtare identike apo të ngjashme për mallrat apo shërbimet identike apo të ngjashme.

2. Çdo aplikim i paraqitur sipas një marrëveshje ndërkombëtare ku Republika e Kosovës është palë, aplikimi i fiton datën e përparësisë në pajtim me dispozitat e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

3. E drejta e përparësisë, ka efekt në rast kur data e përparësisë njihet si data e paraqitjes së aplikimit për regjistrim të markës tregtare.

Neni 28 **E drejta e përparësisë**

1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e markës tregtare ka paraqitur kërkesë për regjistrim të markës tregtare në formë të rregullt në Republikën e Kosovës, nga ndonjë shtet që është palë në Konventën e Parisit apo Marrëveshjen për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, për të njëjtën markë tregtare me mallrat apo shërbime që janë identike apo që i përmbajnë ato për të cilat është paraqitur aplikimi, ai mundet të thirret në të drejtën e përparësisë së paraqitjes

së aplikimit të parë, me kusht që ai të aplikoj për regjistrim të markës tregtare në Republikën e Kosovës brenda gjashtë (6) muajsh nga data e paraqitjes së aplikimit të parë.

2. Aplikuesi që thirret në të drejtën e përparësisë do të shënojë në aplikimin për regjistrimin e markës tregtare të dhënat përkatëse në aplikimin e parë, shtetin, datën numrin e aplikimit dhe jo më vonë se tre (3) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Zyrë, do të dorëzojë një kopje autentike të aplikimit të parë.

3. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 2. i këtij neni e drejta e përparësisë së kërkuar humbet.

4. Çdo paraqitje që është e barasvlershme me një paraqitje të rregullt sipas ligjit të shtetit ku është bërë apo sipas marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe njihet si thirrje në të drejtën e përparësisë.

5. Paraqitje e rregullt nënkupton plotësimin e kushteve të nevojshme për të fituar datën e aplikimit, pavarësisht rezultatit përfundimtar të aplikimit.

Neni 29

E drejta e përparësisë nga ekspozitat

1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e markës tregtare ose trashëgimtari i tij ligjor, ka ekspozuar mallrat apo shërbimet e markës në një ekspozite të njohur zyrtarisht në Republikën e Kosovës, në ndonjë vend të jashtëm, apo në ndonjë shtet anëtar të Unionit të Parisit që është palë në Marrëveshjen për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, për të njëjtën markë me mallra dhe shërbime, në rastin e paraqitjes së aplikacionit për regjistrim në Republikën e Kosovës për të njëjtën markë nën të cilën janë ekspozuar mallrat, ai mund të thirret në të drejtën e përparësisë së datës së ekspozimit të markës për të cilën aplikohet, me kusht që të aplikoj për regjistrim në Republikën e Kosovës brenda gjashtë (6) muajsh nga data e ekspozimit të parë.

2. Aplikuesi që thirret në të drejtën e përparësisë së ekspozimit, parashtron në zyre aplikimin me të gjitha të dhënat përkatëse të ekspozimit të parë të mallrave apo shërbimeve të markës për të cilën aplikohet, datën, shtetin dhe emrin e ekspozitës, jo më vonë se tre (3) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Zyrë, dorëzon dëshmi për ekspozimin e mallrave apo shërbimeve me markën për të cilën aplikohet, vërtetim të lëshuar nga autoriteti kompetent për llojin, vendin, datën e hapjes dhe mbylljes së ekspozitës në aplikacion së bashku me përkthimin e asaj certifikate.

3. Nëse aplikanti nuk i dorëzon të gjitha dokumentet që kërkohen në paragrafin 2. të këtij neni e drejta e përparësisë së ekspozimit së kërkuar humbet.

4. E drejta e përparësisë së ekspozimit e fituar në një vend të tretë nuk vlen në afatin e përparësisë të përmendur në nenin 28 të këtij ligji.

KREU VI

PROCEDURA E REGJISTRIMIT

Neni 30

Ekzaminimi formal i aplikacionit

1. Zyra shqyrton aplikacionet për regjistrimin e markës tregtare dhe gjate ekzaminimit vërteton nëse:

1.1. aplikacioni për regjistrimin e markës i përmbush kërkesat për njohjen e datës së aplikimit sipas nenit 24 paragrafi 1. të këtij ligji;

1.2. aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare i përmbush kërkesat e nenit 5 dhe nenit 23 paragrafi 2. të këtij ligji dhe kushteve të përcaktuara me akte nënligjore sipas këtij ligji;

1.3. është paguar tarifa për aplikimin e regjistrimit të një marke tregtare në pajtim me aktet nënligjore për tarifatat e regjistrimit të markave tregtare.

2. Në rast se aplikimi për regjistrimin e markës tregtare nuk plotëson kërkesat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni, zyra fton aplikuesin që t'i plotësojë mungesat në aplikim brenda gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e pranimit të ftesës nga zyra.

3. Me kërkesën e aplikuesit afati kohor i cekur në paragrafin 2. të këtij neni mund të zgjatet për më së shumti tridhjetë (30) ditë të llogaritura nga data e kalimit të atij afati kohor.

4. Nëse mangësitë apo mos pagesat e përcaktuara në pajtim me nën-paragrafët 1.1. dhe 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni, nuk evitohen në përputhje me kërkesën e Zyrës apo nëse nuk evitohen brenda afatit të caktuar, aplikimi për regjistrimin e markës tregtare nuk do merret në konsiderim. Nëse aplikuesi plotëson aplikacionin sipas kërkesës së Zyrës, atëherë Zyra regjistron si datë të paraqitjes së aplikimit datën në të cilën plotësohen mangësitë.

5. Zyra me vendim refuzon aplikimin nëse mangësitë e përcaktuara në përputhje me nën-paragrafët 1.2. apo 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni nuk plotësohen në pajtim me ftesën e Zyrës apo nëse ato nuk evitohen brenda afatit të përcaktuar kohor.

6. Zyra ekzaminon aplikimet për regjistrim të markave tregtare në formë kronologjike, përveç rasteve kur kërkohet ekzaminimi i parakohshëm i aplikimit nga pala.

7. Forma, procedurat dhe kushtet për ekzaminimin e parakohshëm rregullohen me akt nënligjor.

Neni 31
Ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit

1. Kur marka tregtare sipas nenit 6 të këtij ligji nuk mund të regjistrohet për disa apo të gjitha mallrat apo shërbimet e mbuluara nga aplikimi për regjistrimin e markës tregtare aplikimi refuzohet për ato mallra apo shërbime.
2. Kur marka tregtare përmban ndonjë element që nuk është i dallueshëm dhe len dyshime sa i përket sferës së mbrojtjes, zyra mund të kërkojë si kusht për regjistrim që paraqitësi të deklarojë se ai heq dorë nga e drejta ekskluzive mbi atë elementi. Çdo heqje dore publikohet së bashku me aplikimin apo regjistrimin e markës tregtare.
3. Aplikuesi ka të drejtë që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të njoftimit me shkrim për shkaqet e refuzimit për disa apo të gjitha mallrat apo shërbimet e mbuluara nga aplikacionit, të paraqes vërejtjet dhe të kërkojë plotësimin e aplikacioni dhe /ose të paraqesë dëshmi për faktet e reja të mundshme që do të mund të ndikonin në vendimin përfundimtarë të zyrës për refuzimin e aplikimit për regjistrim.
4. Ky afat kohor mund të zgjatet me kërkesën e aplikuesit, pas pagesës së tarifës e cila duhet të bëhet brenda afatit kohor të përmendur në paragrafin 3. të këtij neni, ky afat kohor mund të zgjatet për më së shumti gjashtëdhjetë (60) ditë të llogaritura nga data e kalimit të atij afati kohor.

Neni 32
Publikimi i aplikimit

1. Nëse aplikimi për regjistrimin e markës tregtare i ka plotësuar kushtet dhe pas shqyrtimit nuk është refuzuar apo hedhur poshtë publikohet në buletin e Zyrës.
2. Të dhënat nga aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare të cilat duhet të publikohen në buletin e Zyrës përcaktohen me akt nënligjor.
3. Kur pas publikimit refuzohet aplikimi sipas nenit 30 dhe 31 të këtij ligji, vendimi përfundimtar mbi refuzimin e aplikimit për regjistrim publikohet në buletin e Zyrës.

Neni 33
Vërejtjet e palëve të treta

1. Çdo subjekt, grup apo organ që përfaqëson prodhuesit, furnizuesit e shërbimeve, tregtarët apo konsumatorët në periudhë prej tre (3) muajsh pas publikimit të aplikimit për regjistrim të markës tregtare, mund t'i parashtrojë Zyrës vërejtje me shkrim, sipas nenit 6 të këtij ligji, duke cekur arsyet dhe vërejtjet pse marka tregtare nuk duhet të regjistrohet sipas detyrës zyrtare. Ata nuk konsiderohen palë në procedurat para zyrës.

2. Vërejtjet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni i komunikohen aplikuesit i cili mund të bëjë përgjigje brenda një tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kopjes së vërejtjeve.

Neni 34 Kundërshtimi

1. Kundërshtimi ndaj një marke të publikuar dorëzohet në zyre brenda afatit kohor prej tre (3) muajsh nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse Brenda periudhës prej tre (3) muajsh të publikimit të aplikimit për regjistrimin e markës tregtare kundërshtimi për regjistrim të markës tregtare duke u mbështetur në faktet që ajo nuk mund të regjistrohet sipas nenit 7 paragrafët 1., 2., dhe 3. të këtij ligji, mund bëhet nga:

1.1. pronarët e markave të mëhershme tregtare sipas nenin 7 paragrafi 2. dhe 4. të këtij ligji si dhe personat që kanë licencën nga pronarët e atyre markave tregtare, sipas nenit 7 paragrafi 1. i këtij ligji;

1.2. pronarët e markës së mëhershme tregtare sipas në nenin 7 paragrafi 3. të këtij ligji;

1.3. nga pronarët e markës së mëhershme tregtare sipas nenit 7 paragrafi 4. të këtij ligji,;

2. Kundërshtimi i regjistrimit të markës tregtare mund të paraqitet sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni në rast të publikimit të ndryshimit të aplikacioni sipas nenit 38 paragrafi 2. i këtij ligji,;

3. Kundërshtimi duhet të behet me shkrim dhe të specifikon arsyen. Mënyra e paraqitjes së kundërshtimit dhe pagesa e tarifës përcaktohet me akt nënligjor.

4. Nëse në datën e publikimit të aplikimi, marka e mëhershme për të cilën bazohet kundërshtimi, është në procedurë të revokimit apo anulimit, Zyra ndalon procedurën e kundërshtimit deri në vendimin valid nga procedura e mëhershme e iniciuar për revokim të procedurës ose procedura për deklarim të pavlefshëm të markës tregtare të merr formë të prerë.

Neni 35 Procedura e shqyrtimit të kundërshtimit

1. Zyra shqyrton nëse kundërshtimi është paraqitur brenda afatit të përcaktuar kohor, nëse është paguar tarifa përkatëse dhe nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me akt nënligjor .

2. Nëse kushtet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni nuk janë plotësuar zyra lëshon vendim për refuzimin e kundërshtimit.

3. Nëse kushtet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni janë plotësuar, zyra i dërgon aplikuesit një kopje të vendimit të kundërshtimit dhe e fton që t'i paraqesë vërejtjet për kundërshtimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të ftesës.

4. Afati kohor i cekur në paragrafin 3. të këtij neni nuk mund të zgjatet dhe pas skadimit të këtij afati nuk mund të paraqiten vërejtje shtesë, përfshirë dëshmi shtesë dhe dokumentim për kundërshtim.

5. Nëse aplikuesi nuk i dorëzon vërejtjet e tij për kundërshtimin brenda afatit të përcaktuar kohor aplikimi për regjistrimin e markës tregtare refuzohet sipas kërkesës së kundërshtimit.

6. Zyra në procedurën e kundërshtimit mund të caktoj seancë për diskutim, nëse vërejtjet e aplikuesit janë bindëse.

Neni 36

Dëshmia e përdorimit të markës së mëhershme tregtare

1. Nëse aplikuesi e kërkon, pronari i markës së mëhershme tregtare i cili ka paraqitur kundërshtim duhet të sigurojë dëshmi që gjatë pesë (5) vitesh para datës së publikimit të kërkesës për regjistrim, marka e mëhershme ka qenë në përdorim në Republikën e Kosovës për mallra apo shërbime për të cilat është regjistruar dhe të cilat i cekë si arsytim për kundërshtimin e tij, ose kur nuk ka arsye për mospërdorimin e markës së mëhershme tregtare me kusht që marka e mëhershme tregtare me atë datë ka qenë e regjistruar për jo më pak se për pesë (5) vite.

2. Në mungesë të dëshmive që marka e mëhershme është përdorur kundërshtimi hidhet poshtë.

3. Nëse marka e mëhershme është përdorur për një pjesë të mallrave apo shërbimeve për të cilat është regjistruar, për nevojat e shqyrtimit të kundërshtimit, ajo konsiderohet e regjistruar vetëm për ato mallra apo shërbimeve.

Neni 37

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e markës dorëzon vërejtjet lidhur me kundërshtimin brenda afatit të caktuar zyra shqyrton arsyetimet e bazës së cekur në kundërshtim.

2. Nëse kundërshtimi vërtetohet që është i paarsyeshëm, zyra me vendim e refuzon atë. Vendimi për refuzim të kundërshtimit i dërgohet të dyja palëve, kundërshtuesit dhe aplikuesit, pasi të ketë marrë vendim të prerë dhe procedura për regjistrimin e markës tregtare për të cilën është aplikuar vazhdon.

3. Nëse vërtetohet që marka nuk mund të regjistrohet për të gjithat mallrat apo shërbimet për të cilat është paraqitur aplikimi, aplikimi për regjistrim refuzohet vetëm për ato mallra dhe shërbime. Vendimi për refuzimin e aplikimit i dërgohet si kundërshtuesit ashtu edhe aplikuesit.

Neni 38

Tërheqja, kufizimi dhe ndryshimi i aplikimit

1. Aplikuesi mundet në çdo kohë ta tërheqë aplikimin për regjistrimin e markës apo të kufizojë listën e mallrave apo shërbimeve të aplikimit. Nëse aplikimi është publikuar atëherë publikohet ashtu siç është ndryshuar apo kufizuar.
2. Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare mund të ndryshohet në bazë të kërkesës së aplikuesit ose nga zyra sipas detyrës zyrtare si korigjimi i emrit adresës, gabimet e dukshme teknike, me kusht që këto korigjime nuk ndikojnë identitetin e markës tregtare ose zgjerojnë listën e mallrave apo shërbimeve.
3. Ndryshimet e cekura në paragrafin 2. të këtij neni pas publikimit të aplikimit dhe pas pagesës së tarifës përkatëse publikohen të ndryshuara.
4. Për procedurat e tërheqjes, kufizimit dhe ndryshimit të aplikimit rregullohen me akt nënligjor

Neni 39

Ndarja e aplikimit

1. Çdo aplikim për markë tregtare me kërkesë të aplikuesit mund të ndahet në disa aplikime lidhur me listën e mallrave dhe shërbimeve të përcaktuar me aplikimin e parë me kusht që të jetë paguar tarifa për ndarjen e aplikimit.
2. Aplikimet e ndara marrin datën apo të drejtën e përparësisë nga aplikimi parë.
3. Paraqitja e kërkesës për ndarje të aplikimit duhet të bëhet sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor

Neni 40

Regjistrimi

1. Kur aplikimi për regjistrimin e markës tregtare i plotëson kërkesat e këtij ligji në veçanti kur baza sipas nenit 6 paragrafi 1. të këtij ligji nuk përbën pengesë për regjistrim dhe brenda afatit të përcaktuar në nenin 34 paragrafi 1. të këtij ligji nuk është paraqitur kundërshtim ndaj regjistrimit, apo kur kundërshtimi i paraqitur është refuzuar apo hedhur poshtë me vendim përfundimtar, zyra e fton aplikuesin që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të

fitesës, të paguajë tarifën e regjistrimit për mbajtjen në fuqi të markës tregtare për dhjetë (10) vite.

2. Nëse nuk është paguar tarifa e mirëmbajtjes së markës tregtare për dhjetë (10) vitet e para brenda afatit të cekur në paragrafin 1. të këtij neni aplikimi për regjistrimin e markës tregtare hidhet poshtë.

3. Nëse brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni është paguar tarifa e mirëmbajtjes për dhjetë (10) vitet e para marka tregtare regjistrohet dhe futet në regjistrin e markave tregtare

4. Pasi që marka tregtare është regjistruar dhe është futur në regjistrin e markave tregtare të dhënat për markën e regjistruar tregtare publikohen në buletin zyrtar të Zyrës. Të dhënat të cilat publikohen përcaktohen me akt nënligjor

Neni 41

Certifikata e markës tregtare

1. Me kërkesën e pronarit të markës tregtare dhe pagesës së tarifës për lëshimin e certifikatës, zyra lëshon certifikatën për markën e regjistruar pas publikimit të saj .

2. Të dhënat nga regjistrimi i markës tregtare të cilat shënohen në certifikatë dhe procedura për lëshim të certifikatës së markës tregtare, përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 42

Ndryshimi i markës së regjistruar tregtare

1. Marka e regjistruar tregtare nuk mund të ndryshohet në regjistrin e markave tregtare përpos në rastet e korrigjimit të gabimeve në formulimin e fjalëve, përfshirë gabime në emrin dhe adresën e pronarit.

2. Publikimi i ndryshimit të regjistrimit duhet të përmbajë ndryshimet e kërkuara nga vet pala .

3. Palët e treta të cilëve ju cenohen të drejtat nga ndryshimi, mund të kundërshtojnë regjistrimin brenda tre (3) muajve nga data e publikimit.

4. Kërkesa për ndryshimin e markës tregtare të regjistruar parashtrohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor

Neni 43
Regjistrimi i ndryshimeve në regjistër

1. Me kërkesë të pronarit të markës tregtare dhe sipas detyrës zyrtare, zyra regjistron në Regjistër të gjitha ndryshimet e bëra pas regjistrimit të markës të cilat nuk ndikojnë në paraqitjen grafike, dukjen e markës, me kusht që në zyrë të jenë dorëzuar dëshmitë e duhura për të vërtetuar që ato ndryshime korrespondojnë me situatën reale dhe është paguar tarifa përkatëse.
2. Ndryshimet e shënuara në Regjistrin e Markave Tregtare publikohen në buletinin e Zyrës.
3. Kërkesa për regjistrim të ndryshimeve paraqitet sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor

Neni 44
Ndarja e regjistrimit

1. Çdo regjistrim për markë tregtare me kërkesë të pronarit të markës mund të ndahet në disa regjistrime për listën e mallrave dhe shërbimeve të përcaktuar me regjistrimin e parë, me kusht që të jetë paguar tarifa për ndarjen e regjistrimit.
2. Regjistrimet e ndara marrin datën apo të drejtën e përparësisë nga regjistrimi i parë.
3. Kërkesa për ndarjen e regjistrimit duhet të parashtrohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor.

KREU VII
VLEFSHMËRIA DHE VAZHDIMI I REGJISTRIMIT TË MARKËS TREGTARE

Neni 45
Vlefshmëria e regjistrimit

Markat tregtare regjistrohen për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh nga data e paraqitjes së aplikimit. Regjistrimet mund të vazhdohen për periudha shtesë prej dhjetë (10) vitesh.

Neni 46
Vazhdimi

1. Regjistrimi i markës tregtare vazhdohet me kërkesë të pronarit me kusht që të jenë paguar tarifatat për vazhdimin e regjistrimit.

2. Kërkesa për vazhdim dorëzohet në zyrë brenda gjashtë (6) muajve para përfundimit të regjistrimit. Nëse brenda këtij afati nuk është bërë kërkesë për vazhdimin e markës tregtare afati mund të zgjatet edhe prej gjashtë (6) muajsh, në këtë rast të paguhet tarifa të dyfishta.
3. Kur kërkesat dorëzohen vetëm për disa mallra apo shërbime për të cilat marka tregtare është regjistruar atëherë regjistrimi vazhdohet vetëm për ato mallra apo shërbime. Kufizimi i listës së mallrave dhe shërbimeve bëhet pasi të paguhet tarifa përkatëse.
4. Vazhdimi fillon prej datës në të cilën mbaron regjistrimi paraparak. Vazhdimi regjistrohet në Regjistrin e Markave Tregtare dhe publikohet në buletin e Zyrës.
5. Nëse regjistrimi nuk vazhdohet, marka tregtare bëhet e pa vlefshme.
6. Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit, tarifën, përcaktohen sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor.

KREU VIII NDERPRERJA E EFEKTEVE TË MARKËS TREGTARE

Neni 47 Heqja dorë

1. Nga marka tregtare mund të hiqet dorë vetëm për disa apo të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar
2. Heqja dorë nga marka bëhet përmes deklaratës me shkrim drejtuar Zyrës nga pronari dhe regjistrohet në regjistrin e markave tregtare dhe publikohet në buletin zyrtar të zyrës.
- 3 Heqja dorë regjistrohet vetëm me pajtim të pronarit të së drejtës së regjistruar për markë tregtare. Nëse licenca është regjistruar, heqja dorë nga marka do të regjistrohet në Regjistrin vetëm nëse pronari i markës dëshmon se e ka informuar të licencuarin lidhur me qëllimin e tij për heqje dorë nga marka.
4. Në bazë të deklaratës mbi heqjen dorë nga marka ndërpritet vlefshmëria e markës nga data kur pronari ka paraqitur deklaratën e tillë.
5. Procedura për heqjen dorë nga marka përcaktohet me akt nënligjor

Neni 48 Shkaqet për Revokim

1. Marka tregtare revokohet me paraqitjen e kërkesës për revokim në Zyrë, nëse:

1.1. brenda periudhës prej pesë vitesh në vazhdimësi marka tregtare nuk është përdorur në Republikën e Kosovës për mallrat apo shërbimet për të cilat është regjistruar dhe nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin e saj; megjithatë, asnjë person nuk mund të kërkojë revokimin e të drejtave të pronarit mbi një markë tregtare nëse gjatë afatit kohor ndërmjet skadimit të afatit pesë (5) vjeçar dhe paraqitjes së kërkesës për revokim, ka filluar apo është vazhduar përdorimi i mirëfilltë i markës tregtare;

1.2. fillimi apo vazhdimi i përdorimit në periudhën tre (3) mujore e cila paraprin kërkesën për revokim dhe e cila ka filluar më herët se pas kalimit të afatit të pandërprerë pesë (5) vjeçar të mospërdorimit, nuk merret parasysh nëse përgatitjet për fillimin apo vazhdimin e përdorimit kanë filluar vetëm pasi që pronari është informuar se kërkesa për revokim mund të paraqitet.

1.3. si pasojë e mosveprimit të pronarit, marka tregtare është bërë emër i zakonshëm në treg për një produkt apo shërbim për të cilin ajo është regjistruar;

1.4. si rezultat i përdorimit të markës tregtare nga pronari ose me lejen e pronarit për mallrat apo shërbimet për të cilat është regjistruar, marka tregtare mund t'i vë në lajthitje publikun, veçanërisht lidhur me natyrën, llojin, cilësinë apo prejardhjen gjeografike të atyre mallrave apo shërbimeve.

2. Kur shkaqet për revokimin e të drejtave ekzistojnë vetëm për disa prej mallrave apo shërbimeve për të cilat është regjistruar marka tregtare, të drejtat e pronarit revokohen vetëm për ato mallra apo shërbime.

3. Kur marka tregtare revokohet, efektet e saj përfundojnë nga data e paraqitjes së kërkesës për revokim.

Neni 49

Kërkesa për revokim

1. Kërkesa për revokim mund t'i dorëzohet zyrës nga çdo person fizik apo juridik grup, apo trup që mbron interesave të prodhuesve, furnizuesve të shërbimeve, tregtarëve apo konsumatorëve, që kanë të drejtë veprimi në emrin e tyre për të ngritur padi dhe për t'u paditur.

2. Kërkesa për revokim parashtrohet me shkrim dhe duhet të cekë në mënyrë specifike arsyet dhe të jetë paguar tarifa përkatëse për revokim. Procedura e paraqitjes së kërkesës për revokim rregullohen me akt nënligjor, kërkesa parashtrohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor

Neni 50

Procedura e revokimit

1. Zyra shqyrton nëse kërkesa për revokim është paraqitur në pajtim nenit 49 paragrafi 2. të këtij ligji nëse është paguar tarifa e përcaktuar për kërkesë për revokim dhe nëse kërkesa për revokim është paraqitur sipas aktit nënligjor.
2. Kur kërkesa për revokim sipas nenit 48, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. të këtij ligji është paraqitur pas skadimit të periudhës prej pesë (5) vitesh nga regjistrimi i markës tregtare për të cilën kërkohet revokimi., zyra refuzon kërkesën për revokim me vendim.
3. Nëse kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni plotësohen atëherë Zyra i dërgon pronarit të markës tregtare një kopje të kërkesës për revokim ashtu dhe e fton atë që brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të ftesës t'i paraqesë vërejtjet e tij mbi kërkesën e paraqitur për revokim.
4. Me kërkesë të pronarit të markës tregtare, e cila duhet të behët sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, afati kohor i cekur në paragrafin 3. të këtij neni, mund të zgjatet për më së shumti gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e kalimit të atij afati kohor.
5. Nëse pronari i markës tregtare nuk i paraqet vërejtjet e tij ndaj kërkesës për revokim brenda afatit të përcaktuar kohor, atëherë regjistrimi i markës tregtare revokohet sipas kërkesës së paraqitur për revokim.
6. Nëse Zyra e sheh të nevojshme ajo mund të organizoj mbajtjen e seancave diskutimi.

Neni 51

Shqyrtimi i kërkesës për revokim

1. Nëse pronari i markës tregtare paraqet vërejtjet mbi kërkesën për revokim brenda afatit kohor të përcaktuar, Zyra shqyrton arsyeshmërinë e shkaqeve të cekura .
2. Nëse gjatë shqyrtimit të i kërkesës për revokim konstatohet se kërkesa është e pabazuar, Zyra e refuzon kërkesën me vendim. Vendimi për refuzimin e kërkesës i dërgohet të dyja palëve.
3. Nëse konstatohet se kërkesa për revokim është e bazuar lidhur me disa apo të gjitha mallrat apo shërbimet për të cilën është regjistruar marka tregtare, atëherë marka revokohet vetëm për ato mallra apo shërbime. Vendimi për revokimin e markës tregtare të regjistruar i dërgohet të dyja palëve.
4. Vendimi përfundimtar për revokimin e markës shënohet në Regjistër dhe publikohet në buletin e Zyrës.

Neni 52

Shkaqet për shfuqizimin e markës tregtare

1. Marka shfuqizohet me paraqitjen e kërkesës në Zyrë:

1.1. kur marka tregtare është regjistruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 dhe 6 të këtij ligji;

1.2. kur aplikuesi në keqbesim ka bërë aplikimin për markën tregtare;

1.3. kur ekziston markë e mëhershme tregtare ashtu siç është përmendur në nenin 7 paragrafi 2. të këtij ligji dhe kur janë përmbushur kushtet e cekura në paragrafin 1. apo paragrafin 3. të nenit 7 të këtij ligji;

1.4. kur ekziston një markë tregtare siç është cekur në nenin 7 paragrafi 4. të këtij ligji dhe kur janë plotësuar kushtet e përcaktuara me atë paragraf;

1.5. kur përdorimi i një marke të tillë tregtare mund të jetë ndaluar në përputhje me një të drejtë të mëhershme, në veçanti në:

1.5.1. të drejte në emër;

1.5.2. të drejte të portretit personal;

1.5.3. të drejte të autorit;

1.5.4. të drejte të pronësisë industriale.

1.6. kur përdorimi i markës tregtare shkel të drejtat e një shenje të përdorur në veprimtaritë afariste në Republikën e Kosovës, nëse ajo shenjë është fituar më herët dhe i jep pronarit të saj të drejtën për ta ndaluar përdorimin e markës tjetër.

2. Kur marka tregtare është regjistruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1. nën-paragrafët 1.2. 1.3. dhe 1.4. të këtij ligji ajo mund të mos shfuqizohet nëse si pasojë e përdorimit të saj, ajo pas regjistrimit ka fituar një veçori dalluese lidhur me mallra apo shërbimet për të cilat është regjistruar.

3. Marka tregtare mund të mos shfuqizohet mbi bazat e një marke të mëhershme tregtare me reputacion apo një marke të mëhershme të mirënjohur tregtare nëse marka e mëhershme tregtare nuk është bërë e mirënjohur sipas nenit 7 paragrafi 2. nën-paragrafi 2.3. të këtij ligji apo nuk ka fituar reputacion sipas nenit 7 paragrafi 3. të këtij ligji deri në datën e të drejtës së përparësisë të markës së mëvonshme tregtare.

4. Kur pronari i njërës prej të drejtave të përmendura në nën-paragrafët 1.3, 1.4, 1.5. dhe 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni, tashmë ka paraqitur kërkesën për shfuqizim të markës tregtare, nuk

mundet të paraqesë kërkesë të re për shfuqizim të markës duke u bazuar në të drejtat e cekura në kërkesën. e mëhershme

5. Kur shkaqet për deklarin e shfuqizimit ekzistojnë lidhur me vetëm për disa nga mallrat apo shërbimet për të cilat marka tregtare është regjistruar, ajo markë tregtare shfuqizohet vetëm për ato mallra apo shërbime.

6. Kur markë tregtare shfuqizohet për të gjitha apo disa nga mallrat apo shërbimet konsiderohet se me shfuqizimin e markës tregtare shuhet të gjitha efektet që ka pasur që nga regjistrimi i saj.

Neni 53

Kërkesa për deklarin e shfuqizimit

1. Kërkesa për deklarin e shfuqizimit mund t'i paraqitet Zyrës:

1.1. nga çdo person fizik apo juridik në zbatim të nenit 52 nën-paragrafi 1.1 të këtij ligji;

1.2. nga subjekti i interesuar në zbatim të nenit 52 nën-paragrafi 1.2 të këtij ligji;

1.3. nga subjektet e cekura në nenin 36 paragrafi 1. të këtij ligji, në zbatim të nenit 52 nën-paragrafët 1.3. dhe 1.4. të këtij ligji

1.4. nga pronarët e të drejtave të mëhershme sipas dispozitave të nenit 52 nën-paragrafët 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji.

2. Kërkesa për deklarin e shfuqizimit parashtrohet me shkrim dhe duhet të cekë në mënyrë specifike arsyet në bazë të cilave kërkohet shfuqizimi i markës tregtare dhe të jetë paguar tarifa përkatëse për shfuqizim. Procedura e paraqitjes së kërkesës për shfuqizim rregullohen me akt nënligjor.

Neni 54

Procedura për deklarin e shfuqizimit

1. Zyra shqyrton se a është paraqitur kërkesa për shfuqizim në pajtim me nenin 53 të këtij ligji, nëse është paguar tarifa e përcaktuar për kërkesën për deklarin e shfuqizimit dhe nëse kërkesa për deklarin e shfuqizimit është paraqitur ashtu siç është përcaktuar sipas akteve nënligjore.

2. Nëse nuk janë përmbushur kërkesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, zyra me vendim refuzon kërkesën për deklarin e shfuqizimit.

3. Nëse kërkesat e përcaktuara me paragrafin 1. të këtij neni janë përmbushur, zyra i dërgon pronarit të markës tregtare një kopje të kërkesës për deklarin e shfuqizimit dhe e fton atë të që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të ftesës të paraqesë vërejtjet mbi kërkesën për deklarin e shfuqizimit.

4. Me kërkesë të pronarit të markës tregtare, afati kohor i cekur në paragrafin 3. të këtij neni mund të zgjatet për gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e skadimit të atij afati kohor duke paguar tarifën shtesë sipas akteve nënligjore.

5. Nëse pronari i markës tregtare nuk i paraqet vërejtjet e tij mbi kërkesën për deklarin e shfuqizimit brenda afatit të përcaktuar kohor, regjistrimi i markës tregtare shfuqizohet sipas kërkesës së parashtruar për deklarin e shfuqizimit.

6. Nëse zyra e sheh të nevojshme ajo mund të organizoj mbajtjen e seancave për diskutim për deklarin të shfuqizimit.

Neni 55

Dëshmia e përdorimit të markës së mëhershme tregtare

1. Me kërkesë të pronarit të markës tregtare, pronari i markës së mëhershme tregtare që është palë në procedurën e shfuqizimit duhet të sigurojë dëshmi, që gjatë periudhës pesë vjeçare para datës së kërkesës për deklarin e shfuqizimit, marka e mëhershme tregtare ka qenë në përdorim në Republikën e Kosovës për mallrat apo shërbimet për të cilat është regjistruar. dhe cilat i citon si arsye për kundërshtimin e tij, apo që ekzistojnë arsye të duhura për mospërdorim, me kusht që marka e mëhershme tregtare deri në atë datë ka qenë e regjistruar për jo më pak se pesë (5) vjet.

2. Nëse në datën publikimit të aplikimi i markës, marka e mëhershme ka qenë e regjistruar për jo më pak se pesë (5) vjet pronari i markës së mëhershme duhet të sigurojë dëshmi se deri në atë datë janë përmbushur kushtet e cekura në nenin 36 të këtij ligji.

3. Kërkesa për deklarin e shfuqizimit refuzohet në mungesë të dëshmive që marka e mëhershme tregtare është përdorur sipas paragrafit 1. të këtij neni.

4. Nëse marka e mëhershme tregtare është përdorur vetëm për një pjesë të mallrave apo shërbimeve për të cilat është regjistruar, atëherë shqyrtimi kërkesës për deklarin e shfuqizimit, bëhet vetëm për atë pjesë të mallrave apo shërbimeve.

Neni 56

Shqyrtimi i kërkesës së vërejtjeve për deklarin e shfuqizimit

1. Nëse pronari i markës tregtare paraqet vërejtjet me shkrim mbi kërkesën për deklarin e shfuqizimit brenda afatit të përcaktuar kohor, zyra shqyrton arsyetimin e tij në bazë të kërkesës.
2. Zyra mund t'i ftojë palët që të paraqesin dëshmi, dokumente dhe vërejtje shtesë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të ftesës. Nëse palët nuk i përgjigjen ftesës së Zyrës brenda afatit të përcaktuar, Zyra merr vendim në bazë të fakteve që i përmban kërkesa për deklarin të shfuqizimit dhe vërejtjeve ndaj asaj kërkesë.
3. Nëse Zyra gjatë shqyrtimit të kërkesës vërteton që kërkesa për deklarin e shfuqizimit është e pabazë, refuzon kërkesën me vendim. Vendimi ju dërgohet palëve.
4. Nëse Zyra gjatë shqyrtimit të kërkesës konstaton se marka nuk ka qenë dashur të regjistrohet për disa apo të gjitha mallrat apo shërbimet për të cilat është regjistruar, atëherë ajo markë tregtare shfuqizohet për ato mallra apo shërbime me vendim. Vendimi ju dërgohet palëve.
5. Vendimi mbi shfuqizimin e markës tregtare për të gjitha apo për disa nga mallrat apo shërbimet, kur merr formën e prerë regjistrohet në Regjistrin e Markave Tregtare dhe publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

KREU IX

MARKAT TREGTARE KOLEKTIVE DHE ÇERTIFIKUESE

Neni 57

Marka kolektive

1. Çdo shenjë sipas nenit 5 të këtij ligji mund të mbrohet si Markë kolektive e cila shfrytëzohet për dallimin e mallrave dhe shërbimeve të anëtarëve të shoqatës si subjekte juridike cila është pronare e markës nga mallrat apo shërbimet e ndërmarrjeve të tjera dhe kur ka për qëllim identifikimin e mallrave apo shërbimeve të vendosura në treg nga anëtarët e shoqatës e cila është pronare e markës.
2. Për regjistrim të markave kolektive mund të aplikojnë shoqatat e prodhuesve, furnizuesve të shërbimeve apo tregtarëve të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë të drejtë që në emrin e tyre të nënshkruajnë kontrata apo të ndërmarrin veprime të tjera ligjore dhe mund të jenë të paditura dhe të padisin sikurse çdo person tjetër juridik.

Neni 58

Marka certifikuese

1. Si markë certifikuese mund të mbrohet çdo shenjë sipas nenit 5 të këtij ligji, e cila ka për qëllim përcaktimin e cilësisë, prejardhjes, mënyrës së prodhimit apo veçori të tjera të përbashkëta të mallrave apo shërbimeve.
2. Pronari i markës certifikuese nuk ka të drejtë ta përdorë vetë një markë certifikuese por ka të drejtë të autorizojë dhe mbikëqyrë përdorimin e markës nga subjektet e autorizuar që përdorin markën në pajtim me rregullat e përdorimit të markës certifikuese.

Neni 59

Dispozitat e veçanta për markën kolektive dhe certifikuese

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për markat kolektive dhe certifikuese, nëse në nenet 59 deri 67 nuk parashihet ndryshe.
2. Në përjashtim nga neni 6 nën-paragrafi 1.3 të këtij ligji, shenjat apo indikacionet që mund të shërbejnë, në tregti, për të emërtuar prejardhjen gjeografike të mallrave apo shërbimeve mund të regjistrohen si marka kolektive apo certifikuese.
3. E drejta e një markë kolektive apo certifikuese nuk i jep të drejtë pronarit që ta ndalojë një palë të tretë që në veprimtaritë afariste të përdorë shenja apo indikacione të tilla, me kusht që ai i përdor ato në pajtim me praktikatat e ndershme industriale apo tregtare, sidomos ndaj palës së tretë që ka të drejtën ta përdorë treguesi gjeografik.

Neni 60

Kontrata për përdorimin e markës kolektive dhe certifikuese

1. Aplikuesi i markës kolektive apo certifikuese duhet që së bashku me aplikimin për regjistrimin e markës kolektive apo certifikuese të paraqesë Kontratën e cila specifikon përdorimin e saj.
2. Kontrata që specifikon përdorimin e markës kolektive duhet të theksojë në mënyrë të qartë personat e autorizuar për përdorimin e markës, kushtet e anëtarësisë së subjektit dhe nëse ekzistojnë kushtet e përdorimit të markës dhe sanksionet që pasojnë në rast të keqpërdorimit të markës kolektive apo certifikuese apo në rast të shkeljes së rregullave.
3. Kontrata që përcakton përdorimin e markës certifikuese specifikon personat e autorizuar për përdorim të markës, karakteristikat për të qenë markë e certifikuar se si organi certifikues i teston ato karakteristika dhe se si t'i mbikëqyrë përdorimin e markës, tarifave që duhet të paguhet lidhur me përdorimin dhe procedurat për zgjedhjet e mosmarrëveshjeve.

4. Me anë të kontratës përcaktohet përdorimi i markës sipas nenit 59 paragrafi 2. i këtij ligji i cili duhet të autorizojë cilindo person, mallrat apo shërbimet e të cilit e kanë prejardhjen e tyre në zonën gjeografike, në mënyrë që të bëhen anëtarë të subjektit e cila është pronare e markës.

Neni 61

Refuzimi i aplikimit

1. Përveç kushteve për refuzimin e aplikimit për regjistrimin e markës tregtare sipas nenit 30 dhe 31 të këtij ligji, aplikimi për regjistrimin e markës kolektive apo certifikuese refuzohet edhe kur nuk përmbushen kërkesat sipas dispozitave 57, 58 dhe 60 të këtij ligji dhe kur ato janë në kundërshtim me rendin publik apo moralin.
2. Aplikimi për regjistrimin e markës kolektive apo certifikuese po ashtu refuzohet nëse ka gjasa që publiku të mashtrohet lidhur me karakterin apo rëndësinë e markës në veçanti nëse duket si diçka tjetër dhe jo si marke kolektive apo certifikuese.
3. Aplikimi nuk refuzohet nëse aplikuesi plotëson kushtet sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni si rezultat i ndryshimit të kontratës që specifikon përdorimin e markës.

Neni 62

Vërejtjet nga palët e treta

Çdo person, grup apo organ i përmendur në nenin 33 të këtij ligjimund t'i dorëzojë vërejtjet me shkrim në zyrë bazuar në shkaqet e përmendura mbi të cilat sipas kushteve të nenit 61 të këtij ligji duhet të refuzohet kërkesa për markë kolektive apo certifikuese.

Neni 63

Përdorimi i markave kolektive dhe certifikuese

Të drejtën e përdorimit të markës kolektive apo certifikuese e ka çdo subjekt që është i autorizuar ta përdorë atë sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 64

Ndryshimi i kontratës që përcakton përdorimin

1. Pronari i markës kolektive apo certifikuese duhet t'ia dorëzojë zyrës çfarëdo ndryshimi të kontratës që rregullojnë përdorimin e markës.
2. Ndryshimi nuk bëhet në regjistrin e markave tregtare nëse kontratat e ndryshuara nuk i përmbushin kërkesat e nenit 60 të këtij ligji apo nëse ato përfshijnë ndonjërin prej arsyeve për refuzimin sipas nenit 61 të këtij ligji.

3. Neni 62 i këtij ligji zbatohet për kontratat e ndryshuara që përcaktojnë përdorimin.
4. Ndryshimet në kontrata që rregullojnë përdorimin kanë ndikim ndaj palëve të treta vetëm nga data e shënimit të ndryshimit në Regjistrin e Markave Tregtare.

Neni 65

Personat që kanë të drejtë të ndërmarrin veprime kundër shkeljeve

1. Dispozitat e nenit 96 të këtij ligji lidhur me të drejtat e personave të pajisur me licencë zbatohen edhe për personat që janë të autorizuar të përdorin markën kolektive apo certifikuese.
2. Pronari i markës kolektive apo certifikuese ka të drejtën për të kërkuar kompensim në emër të personave që kanë autorizim ta përdorin markën, kurdo që personat e autorizuar kanë pësuar dëm si pasojë e përdorimit të paautorizuar të markës.

Neni 66

Bazat për revokim të markave kolektive dhe certifikuese

1. Përveç bazave të parapara për revokim sipas nenit 48 të këtij ligji, të drejtat e pronarit të markës kolektive apo certifikuese revokohen me paraqitjen e kërkesës në zyre nëse:
 - 1.1. pronari nuk ndërmerr hapa të arsyeshëm për te parandaluar përdorimin e markës në mospërputhje me kushtet e përdorimit të përcaktuara në kontratat që rregullojnë përdorimin e tyre;
 - 1.2. mënyra e përdorimit të markës tregtare nga pronari ka bere që ajo të shkaktojë lajthitje të publikut sipas nenit 61 paragrafit 2. të këtij ligji;
 - 1.3. nëse ndryshimi i rregullave për përcaktimin e përdorimit të markës është shënuar në Regjistrin e Markave Tregtare në kundërshtim me dispozitat e nenit 64 paragrafit 2. të këtij ligji përveç nëse pronari i markës ndryshon rregullat e përcaktuara të përdorimit dhe është në pajtim me kërkesat e atyre dispozitave

Neni 67

Bazat për shfuqizim të markave kolektive dhe certifikuese

Pavarësisht bazës për shfuqizim të paraparë në nenin 52 të këtij ligji, marka kolektive apo certifikuese shfuqizohet me paraqitjen e kërkesës në Zyrë nëse është regjistruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të këtij ligji.

KREU X REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR I MARKAVE

Neni 68 Zbatimi i dispozitave

1. Përveç nëse ky kapitull e parasheh ndryshe , dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore sipas këtij ligji zbatohen ndaj:

1.1. aplikimeve për regjistrim ndërkombëtar të markës sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Madridit.

1.2. regjistrim i ndërkombëtarë i markave që përcaktohen për Republikën e Kosovës

Neni 69 Aplikimi për regjistrim ndërkombëtar

Aplikimi për regjistrim ndërkombëtar dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimit në regjistrin ndërkombëtarë sipas nenin 68 nën-paragrafi 1.1. të këtij ligji i paraqitet Zyrës sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akte nënligjore

Neni 70 Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar

Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar i paraqitet Zyrës sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akte nënligjore

Neni 71 Përmbajtja e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar dhe kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar

1. Aplikimi për regjistrimin ndërkombëtar dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimit në Regjistrin Ndërkombëtar parashtrahet ashtu siç është paraparë nga Marrëveshja e Madridit, Protokollin e Madridit, rregulloret e përbashkëta sipas marrëveshjes së Madridit lidhur me regjistrimin ndërkombëtar të markave dhe protokollin lidhur me atë marrëveshje (që tani e tutje njihen si “Rregulloret e Përbashkëta”), dhe sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore.

2. Paraqitja e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar i nënshtrohen pagesës së tarifës përkatëse në Zyrë.

Neni 72

Shqyrtimi i aplikimit për regjistrim ndërkombëtar dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin ndërkombëtar

1. Kur aplikimi për regjistrim ndërkombëtar apo kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar nuk i plotëson kërkesat e parapara në nenin 71 të këtij ligji, Zyra kërkon nga paraqitësi që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës t'i evitojë mangësitë apo mungesën e pagesës nga data e pranimit të kërkesës.
2. Me kërkesë të aplikuesit, e cila duhet të parashtrohet brenda afati kohor të cekur në paragrafin 1. të këtij neni, afati kohor mund të zgjatet për më së shumti tridhjetë (30) dite nga data e skadimit të afatit kohor.
3. Nëse mangësitë sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk evitohen në përputhje me kërkesën e Zyrës apo nëse ato nuk evitohen brenda afatit të caktuar kohor, Zyra hedh poshtë aplikimin për regjistrim ndërkombëtar apo kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar.
4. Kur aplikimi për regjistrim ndërkombëtar apo kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar janë në përputhje me kërkesat e parapara me nenin 71 të këtij ligji dhe nëse është paguar tarifa e paraparë, atëherë Zyra në afatin më të shkurtër të mundur i transmeton Byrosë ndërkombëtare aplikimin për regjistrim ndërkombëtar apo kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar

Neni 73

Tarifat sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Madridit

Tarifat që duhet të paguhen sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Madridit i paguhen drejtpërdrejt Byrosë Ndërkombëtare.

Neni 74

Regjistrimi i markave tregtare ne regjistrin nderkombetare

1. Data dhe numri i regjistrimit ndërkombëtar të bazuar në aplikimin për regjistrimin e marke tregtare, regjistrohet në dosjet e atij aplikimi. Kur aplikimi përfundon me regjistrimin e një marke tregtare, atëherë data dhe numri i regjistrimit ndërkombëtar regjistrohen në Regjistrin e Markave Tregtare që mbahet nga Zyra.
2. Data dhe numri i regjistrimit ndërkombëtar të bazuar në regjistrimin e markës tregtare shënohet në Regjistrin e Markave Tregtare që mbahet nga Zyra.

Neni 75
Refuzimi i regjistrimit ndërkombëtar

Regjistrimet ndërkombëtar të destinuara për njohje në Republikën e Kosovës i nënshtrohen shqyrtimit për bazat absolute të refuzimit sikur edhe aplikimi kombëtar për regjistrimin e markës tregtare, përveç që afati i përcaktuar në nenin 31 paragrafin 4. të këtij ligji zëvendësohet me afatin kohor prej njëqindnjëzet (120) ditësh nga data e njoftimit mbi refuzimin e regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 76
Kundërshtimi i regjistrimit ndërkombëtar

1. Regjistrimet ndërkombëtar të destinuara për njohje në Republikën e Kosovës i nënshtrohen kundërshtimeve në të njëjtën mënyrë sikur edhe aplikimi për regjistrim kombëtar i publikuar, përpos që publikimi i një aplikimi të cekur në nenin 32 të këtij ligji zëvendësohet nga publikimi në gazetën zyrtare të regjistrimeve ndërkombëtare të publikuara nga Byroja Ndërkombëtare (këtej e tutje: gazeta e WIPO-s) dhe afati kohor për paraqitjen e kundërshtimit fillon prej ditës së parë të muajit vijues të publikimit në Gazetën e WIPO-s.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni zbatohen për vërejtët e palës së tretë sipas nenit 33 të këtij ligji për regjistrimet ndërkombëtare të përcaktuara për Republikën e Kosovës

Neni 77
Procedura lidhur me kundërshtimin e regjistrimit ndërkombëtar

1. Procedura e kundërshtimit lidhur me regjistrimin ndërkombëtar për njohje në Republikën e Kosovës është e njëjtë me procedurën lidhur me kundërshtimin e një aplikimi kombëtar për regjistrimin e marke tregtare, përpos që në vend të nenit 35 paragrafi 3. të këtij ligji zbatohen dispozitat e paragrafëve 2., 3., 4. dhe 5. të këtij neni.

2. Zyra sipas Marrëveshjes së Madridit apo Protokollit të Madridit i dërgon pronarit të regjistrimit ndërkombëtar njoftimin për refuzim të përkohshëm sipas një kundërshtimi të parashtruar dhe e fton atë që të emërojë një përfaqësues i cili brenda njëqindnjëzet (120) ditësh nga data e njoftimit t'i paraqet autorizimin Zyrës.

3. Pasi përfaqësuesi ta ketë dorëzuar autorizimin, Zyra i dërgon përfaqësuesit një kopje të kundërshtimit.

4. Afati kohor për dorëzimin e vërejtjeve mbi kundërshtimin e regjistrimit ndërkombëtar është gjashtëdhjetë (60) dite nga data e pranimit të kopjes së kundërshtimit nga përfaqësuesi.

5. Afati kohor i cekur në paragrafin 2. dhe 4. të këtij neni nuk zgjatet dhe pas kalimit të këtij afati nuk mund të dorëzohet asnjë dokument shtesë.

Neni 78

Procedura për anulimin dhe shfuqizimin e një regjistrimi ndërkombëtar

1. Procedura e anulimit dhe shfuqizimit i regjistrimit ndërkombëtar për njohje në Republikën e Kosovës është e njëjtë me procedurën lidhur me anulimit dhe shfuqizimit e aplikimit kombëtar për regjistrimin e një marke tregtare, përveç se në vend të nenit 50 paragrafi 3. dhe nenit 54 paragrafi 3. të këtij ligji zbatohen dispozitat e paragrafëve 2., 3., 4. dhe 5. të këtij neni.
2. Zyra në pajtim me Marrëveshjen e Madridit apo Protokollin e Madridit, e njofton pronarin e regjistrimit ndërkombëtar lidhur me kërkesën e parashtruar për anulim apo shfuqizim dhe e fton atë që të emërojë një përfaqësues i cili brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të njoftimi ia dorëzon autorizimin Zyres.
3. Afati kohor sipas paragrafit 2. të këtij neni zgjatet edhe për gjashtëdhjetë (60) dite.
4. Pasi përfaqësuesi ta ketë dorëzuar autorizimin, Zyra i dërgon një kopje të kërkesës për anulim apo shfuqizim.
5. Afati për dorëzimin e vërejtjeve ndaj kërkesës për anulim apo shfuqizim të regjistrimit ndërkombëtar është gjashtëdhjetë (60) dite nga data kur përfaqësuesi e pranon kopjen e kërkesës për anulim apo shfuqizim.

Neni 79

Dëshmia e përdorimit të regjistrimit ndërkombëtar

1. Për të dëshmuar përdorimin e regjistrimit ndërkombëtar në procedurën e kundërshtimit, shfuqizimit apo të anulimit të markës tregtare si data të regjistrimit të markës tregtare ndërkombëtare, merren data e skadimit të periudhës një (1) vjeçare që fillon nga dita në vijim të datës së njoftimit të komunikuar nga Byroja Ndërkombëtare mbi regjistrimin ndërkombëtar që kërkon njohje në Republikën e Kosovës.
2. Nëse me rastin e skadimit të periudhës njëvjeçare të cekur në paragrafin 1. të këtij neni, procedura e regjistrimit ndërkombëtar në Republikën e Kosovës ende nuk ka përfunduar, atëherë data kur Zyra ka njoftuar Byronë Ndërkombëtare mbi vendimin e saj për dhënien e mbrojtjes, merret si data e regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 80

Transformimi i një regjistrimi ndërkombëtar

Regjistrimi ndërkombëtar i markës, mund të transformohet në aplikim për markë tregtare kombëtare sipas nenit 9quinquies të Protokollit të Madridit dhe sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor

Neni 81

Zëvendësimi i një marke tregtare me një regjistrim ndërkombëtar

Me paraqitjen e kërkesës për zëvendësim Zyra regjistron në Regjistrin e Markave Tregtare, që marka tregtare zëvendësohet me regjistrim ndërkombëtar sipas nenit 4bis të Protokollit të Madridit apo Marrëveshjes së Madridit

KREU XI

MARKA TREGTARE KOMUNITARE

Neni 82

Vazhdimi i efekteve të markës tregtare Komunitare

Efektet e aplikimit për marke tregtare Komunitare të paraqitura dhe të fituara para anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, vlejnë edhe për territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 83

Marka tregtare komunitare si markë e mëhershme tregtare

1. Në zbatim të nenit 7 të këtij ligji aplikimi për markë tregtare Komunitare apo marka tregtare Komunitare janë marka të mëhershme tregtare krahasuar me aplikimet kombëtare për regjistrimin e markave tregtare dhe markat tregtare kombëtare që janë fituar mbi bazën e atyre aplikimeve pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.
2. Sipas nenit 7 të nën-paragrafit 2.1.3. të këtij ligji, një markë e mëhershme tregtare Komunitare që ka emër në Bashkimin Evropian merret parasysh në pajtim me dispozitat e nenit 9, paragrafi (1), pika (c) e rregullores për markat tregtare komunitare.
3. Marka tregtare kombëtare mund të mos shfuqizohet edhe pse është në konflikt me markë të mëhershme tregtare komunitare, po që se marka e mëhershme tregtare komunitare nuk i plotëson kushtet e përdorimit të parapara në nenin 15 të rregullores për markën tregtare komunitare.

Neni 84

Procedimi i një aplikimi për markat tregtare Komunitare

Nëse aplikimi për marka tregtare komunitare i paraqitet Zyrës në përputhje me nenin 25 të rregullores për markat tregtare komunitare, atëherë paguhet tarifë përkatëse dhe aplikimi paraqitet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor.

Neni 85
**Transformimi i aplikimit për markë tregtare komunitare dhe i markës tregtare
komunitare në aplikim kombëtar**

1. Me kërkesë për transformimin e aplikimit për markë tregtare komunitare apo marke tregtare komunitare, transformimi në aplikim kombëtar për regjistrimin e markës tregtare, të parashtruar në përputhje me dispozitat e nenit 110, paragrafi (3) të rregullores për marka tregtare komunitare dhe sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me akt nënligjor, Zyra kryen i procedurat për regjistrimin e markave tregtare në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
2. Për regjistrim e cekur në paragrafin 1. të këtij neni Zyrës duhet t'i paguhet tarifa përkatëse.
3. Data e paraqitjes, data e përparësisë, data e vjetërsisë përcaktohen në përputhje me dispozitat e nenit 109 paragrafi 3. të rregullores për markën tregtare të komunitare.

Neni 86
Vjetërsia e markës tregtare

1. Vjetërsia e markes tregtare kombëtare sipas neneve 34 dhe 35 të rregullores mbi markën tregtare komunitare, mund të kërkohet për markë tregtare komunitare nëse:
 - 1.1. marka tregtare kombëtare është fituar para hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian; dhe
 - 1.2. marka tregtare kombëtare ka përparësi ndaj markës tregtare komunitare për të cilën kërkohet vjetërsia.
2. Kur për marken tregtare komunitare është kërkuar vjetërsia e markës së mëhershme tregtare, marka e mëhershme tregtar shpallet e pavlefshme ose tërhequr sipas këtij ligji pas heqjes dorë apo skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

Neni 87
Ndalimi i përdorimit të markave tregtare komunitare

1. Nëse përdorimi i një marke tregtare komunitare sipas nenit 83 të këtij ligji është në konflikt me përdorimin e një marke tregtare kombëtare të fituar para anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian apo të fituar mbi bazën e një aplikimi kombëtar, të paraqitur para antarsimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, pronari i markës tregtare kombëtare mund të inicioj procedurë ligjore, duke kërkuar ndalimin e përdorimit të markës tregtare komunitare në Republikën e Kosovës, ndikimi i së cilës është vazhduar në territorin e Republikës së Kosovës sipas nenit 83 të këtij ligji.

2. Pronari duhet të dëshmojë që marka tregtare komunitare është në konflikt me markën e tij tregtare kombëtare.

Neni 88

Mbrojtja e markës tregtare komunitare ndaj shkeljeve

Në rast të shkeljes së të drejtave të marke tregtare komunitare zbatohen dispozitat për mbrojtjen e markes tregtare kombëtare

Neni 89

Gjykata kompetente për markë tregtare komunitare

Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të markës tregtare komunitare vendos Gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU XII

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA LIDHUR ME PROCEDURËN PARA ZYRËS

Neni 90

Shqyrtimi i vendimeve të marra nga Zyra

1. Kundër vendimeve të Zyrës lejohet ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit.
2. Ankesa i drejtohet komisionit që obligohet të vendosë dhe ta njoftojë palën.
3. Komisioni i shqyrtimit të ankesave formohet me vendim të Ministrit.
4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.
5. Kompetencat, mandati dhe puna e komisionit rregullohen me akt nënligjor.

Neni 91

Tarifat

Të gjitha tarifat të cilat duhet të paguhen për procedurat e rregulluara me këtë ligj, përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 92
Dispozitat e tjera që zbatohen në procedurën para Zyrës

Në mungesë të dispozitave të këtij ligj dhe akteve nënligjore përkatës, Zyra për çështjet procedurale specifike zbaton dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative, Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe ligjet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 93
Regjistrat

1. Zyra udhëheq dhe mban Regjistrat e Markave Tregtare dhe Regjistrin e Agjentëve të Markave Tregtare.
2. Përmbajtjet dhe metoda e udhëheqjes dhe mbajtjes së regjistrave të cekur në paragrafin 1. të këtij neni përcaktohen me aktet nënligjore.
3. Regjistri i Markave Tregtare i cekur në paragrafin 1. të këtij neni është publike.
4. Me kërkesë me shkrim të personit të interesuar, Zyra lëshon kopje të shënimeve apo ekstrakte të regjistrave pasi të paguhet tarifa e paraparë.

Neni 94
Vazhdimi i procedurave

1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e markës tregtare apo pronari i saj nuk ka vepruar në përputhje me afatin kohor për ndonjë veprim në procedurën në Zyrë dhe ai mosveprim ka pasojë të drejtpërdrejtë në humbjen e drejtave të fituara nga aplikimi për markën tregtare apo nga marka tregtare e regjistruar, ai mund të parashtojë kërkesë për vazhdimin e procedurave lidhur me aplikimin e markës tregtare apo markën tregtare të regjistruar Zyra lejon vazhdimin e procedurave me kusht që aplikuesi:
 - 1.1. kryen të gjitha veprimet e lëshuara brenda afatit kohor, të cekur në paragrafin 2. të këtij neni; dhe
 - 1.2. paguan tarifën në pajtim me aktet nënligjore.
2. Kërkesa për vazhdimin e procedurave duhet të parashtrohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas kalimit të afatit kohor të cekur në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Nëse veprimet e kërkuara nuk janë kryer brenda afatit kohor të cekur në paragrafin 2. të këtij neni apo nëse nuk është paguar tarifa përkatëse, kërkesa për vazhdimin e procedurave konsiderohet sikur të mos jetë parashtruar fare.
4. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohen për afatet kohore të cekura në:

- 4.1. paragrafin 2. të këtij neni;
- 4.2. nenin 28 dhe 29 të këtij ligji;
- 4.3. nenin 45 të këtij ligji;
- 4.4. për parashtrim te kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme (*restitutio in integrum*) sipas dispozitave te Ligjit mbi Procedurat Administrative;
- 4.5. për gjitha veprimet në procedurat pranë Zyrës që përfshijnë disa palë.

5. Nëse kërkesa është në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, por ndonjëra nga veprimet nuk është në përputhje me një afat kohor, konsiderohet se veprimi nuk ka ndodhur dhe të gjitha veprimet e iniciuara dhe të ndërmarra nga Zyra anulohen.

KREU XIII

MBROJTJA CIVILO – JURIDIKE

Neni 95

Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave

Padinë në rast të shkeljes së të drejtave të markës tregtare sipas këtij ligji kanë të drejtë ta ushtrojnë pronari i markës tregtare, pronari i licencës ekskluzive sipas kontratës apo bartësi i së drejtës së markës tregtare

Neni 96

Procedura për konstatimin dhe ndalimin e shkeljes

1. Pronari i markës tregtare mund të parashtojë padi në gjykatë për konstatimin e shkeljes së të drejtës së markës tregtare kundër personit i cili ka shkelur të drejtën e markës duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji duke kërkuar:

- 1.1. vërtetimin e shkeljes së markës;
- 1.2. ndalimin e shkeljes dhe ndalimin e vazhdimet të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme në të ardhmen;
- 1.3. ndalimin dhe ndërprerjen e mëtutjeshëm të shkeljes së të drejtave të fituara në bazë të nenit 8 paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, që kanë shkaktuar apo përbëjnë tentim serioz për shkeljen e mundshme të markës së tij tregtare.

2. Veprimet e cekura në paragrafit 1., nën-paragrafët 1.1, 1.2. dhe 1.3. të këtij neni që gjithashtu mund të bëhen kundër personave të cilët gjatë aktivitetit të tyre ekonomike kanë kryer shërbime duke shkelur markën apo bënë kërcënim për shkelje të të drejtave të markës.

Neni 97

Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve

1. Pronari i të drejtës së markës tregtare mund të inicioj procedurë gjyqësore kundër çdo personi që ka shkelur të drejtat e markës tregtare duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, duke kërkuar që produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit.
2. Gjykata cakton masën përkatëse kundër të paditurit me shpenzime të të paditurit përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të veçanta që të mos ndërmerret një veprim të tillë.
3. Shqiptimi i masës nga gjykata sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të jetë në proporcion me shkeljen.

Neni 98

Kërkesa për kompensim të dëmit

1. Pronari i markës tregtare mund të inicioj padi kundër personit i cili i ka shkaktuar dëm duke kryer pa autorizim veprimet sipas nenit 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, dhe të kërkojë kompensimin e dëmit.
2. Pronari i markës tregtare mund inicioj padi kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet sipas nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të këtij ligji, duke kërkuar kompensimin në shumën që ai e ka kërkuar në kontratën për licencën nëse ajo ekziston .
3. Pronari i markës tregtare mund të inicioj padi kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet e cekura në nenin 8 paragrafi 1. dhe 2. të këtij ligji, i cili ka përfituar pa bazë ligjore duke shkelur markën tregtare të huaj, dhe të kërkojë kthimin apo kompensimin e atyre përfitimeve, sipas dispozitave të përgjithshme për përfitimin pa bazë.
4. Kërkesat sipas paragrafit 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.

Neni 99

Kërkesa për publikimin e aktgjykimit

1. Me kërkesën e pronarit të markës tregtare aktgjykimi i formës së prerë, publikohet në mjetet e informimit publik me shpenzimet e të paditurit.

2. Gjykata vendos brenda kufijve të kërkesës për publikimin e tërësishëm ose pjesërisht të aktgjykimit dhe mjetin e informimit se ku do të bëhet publikimi.

Neni 100 **Kërkesa për informacione**

1. Pronari i markës tregtare i cili ka filluar procedurën për mbrojtjen e markës tregtare në rastet e shkeljes, mund të kërkojë informacionet për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve që shkelin markën.

2. Kërkesa sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të paraqitet në formë të padisë ose për marrjen e masave të përkohshme kundër:

2.1. personit kundër të cilit është ngritur padi sipas paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. personit i cili në kuadër të aktivitetit të tij afarist posedon produkte për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelur markën;

2.3. personit i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij afarist ofron shërbime, për të cilat dyshohet se shkelin markën;

2.4. personave të cilët gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre afarist ofrojnë shërbime apo përdorin shërbimet e ofruara në aktivitetet e dyshuara që shkelin markën;

2.5. personit për të cilin dëshmohet se është përfshirë në prodhimin ose shpërndarjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve të dyshuara se shkelin markën.

3. Kërkesa për informacione për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të përfshijë në veçanti:

3.1. informatat për emrat dhe adresat e prodhuesve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronarëve të tjerë të mëparshëm të produkteve dhe shërbimeve, shitësve me shumicë dhe pakicë;

3.2. informatat për sasinë e prodhuara, shpërndara, pranuar dhe porositura, si dhe çmimin për produktet dhe shërbimet.

4. Nëse personi në fjalë refuzon të ofrojë informacione pa arsye bindëse, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Dispozitat e këtij neni nuk vlejnjë për përdorimin e informacioneve të fshehta.

6. Dispozitat e këtij neni nuk vlejnjë për dispozitat të neneve 103 dhe 104 të këtij ligji që rregullojnë marrjen e dëshmive.

Neni 101

Masat e përkohshme në rastet e shkeljes së markës tregtare

1. Me kërkesën e pronarit të markës tregtare i cili dëshmon se marka tregtare është shkelur apo tentohet të shkelet, gjykata mund të urdhërojë çfarëdo mase të përkohshme që përfshin ndalimin apo parandalimin e shkeljes dhe në veçanti:

1.1. të urdhëroj shkelësin e supozuar që t'i ndalojë dhe t'i ndërpresë veprimet që shkelin markën tregtare; gjykata po ashtu mund të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare.

1.2. të urdhëroj konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare.

2. Me kërkesën e pronarit të markës i cili dëshmon se marka e tij është shkelur në veprimtari afariste me qëllim të sigurimit të përfitimit material dhe shkelja ka tentuar që t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm ose vështirë të riparueshëm, gjykata përveç masave të përkohshme të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të palës kundërshtuese, e cila nuk është drejtpërdrejt e lidhur me shkeljen, duke përfshirë edhe ngrirjen e llogarive të tij bankare.

3. Me qëllim të caktimit dhe ekzekutimit të masës së përkohshme sipas paragrafit 2. të këtij neni, gjykata kërkon nga pala kundërshtare ose personat e tjerë përkatës, paraqitjen e informacioneve bankare, financiare dhe informacioneve të tjera ekonomike, ose vënien në dispozicion të informacioneve dhe dokumenteve të tjerë në lidhje me to. Gjukata siguron mbrojtjen e konfidencialitetit të informacioneve të tilla dhe e ndalon shpërdorimin e tyre.

4. Në qoftë se një masë e përkohshme është urdhëruar pa e njoftuar palën kundërshtare, gjykata do të komunikojë vendimin për masën e përkohshme për palën kundërshtare, menjëherë pas zbatimit të tij.

5. Në vendimin për masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse është urdhëruar ndonjë masë para fillimit të procedurës, periudhën brenda së cilës paraqitësi i kërkesës për masën inicion procedurë për të arsyetuar masën, në afat prej njëzet (20) ditë pune dhe jo më e gjatë se tridhjetenjë (31) ditë kalendarike, nga data e shqiptimit të masës së përkohshme.

Neni 102

Masat e përkohshme për ruajtjen e dëshmisë

1. Sipas kërkesës së pronarit të markës i cili pohon se i është shkelur e drejta ose ekziston rreziku të shkelet dhe ekziston mundësia që dëshmia e shkeljes ose rrezikut në fjalë nuk mund të merret ose bëhet e vështirë të merret, gjykata urdhëron marrjen masës së përkohshme për ruajtjen e dëshmisë.

2. Me masën e përkohshme të cekur në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të urdhëroj:
- 2.1. përgatitjen e një përshkrimi të hollësishëm të produkteve që rrezikojnë të shkelin një markë tregtare, me apo pa marrjen e mostrave;
 - 2.2. konfiskimin e mallrave që vërtetohet se ka shkelur një markë tregtare;
 - 2.3. konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave të cilat shkelin të drejtat e një markë tregtare dhe dokumentacionin lidhur me to.
3. Masa e përkohshme e cekur në këtë nen mund të urdhërohet edhe pa informuar palën tjetër, nëse kërkuesi i masave të përkohshme tregon qartë që ekziston rreziku që të dëmtohen dëshmitë apo do të ndodhë dëm i riparueshëm. Nëse urdhërohet një masë e përkohshme pa informuar palën tjetër, gjykata ia komunikon palës tjetër vendimin mbi masën e përkohshme menjëherë pasi që zbatohet.
4. Në vendimin që urdhëron një masë të përkohshme, gjykata e specifikon kohëzgjatjen e masës dhe nëse masa është urdhëruar para fillimit të procedurës ligjore, periudhën brenda së cilës kërkuesi i masave duhet të fillojë procedurë ligjor për të arsyetuar masën brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e komunikimit të vendimit.
5. Kur masat e përkohshme sipas këtij neni tërhiqen apo ju kalon afati për shkak të lëshimeve nga paditësi, ose kur dëshmohet që nuk ka pasur shkelje apo tentim për shkeljen e markës tregtare, gjykata me kërkesën e palës së paditur mund të urdhëroj paditësin që të kompensoj palën e paditur për çdo padrejtësi apo dëm të shkaktuar nga masat e përkohshme. Për të siguruar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga masat e përkohshme pala paditëse duhet të depozitoj mjete të mjaftueshme për kompensimin e dëmit.
6. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën e Përmbarrimit zbatohen në çështjet që nuk janë rregulluar me këtë nen.
7. Dispozitat e këtij ligji nuk përjashton mundësin gjykatës për të urdhëruar masa të përkohshme që përfshijnë ruajtjen e dëshmive në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Neni 103

Sigurimi i dëshmive gjatë procedurës

1. Kur pala në procedurën kërkon dëshmi që i përkasin palës kundërshtare, gjykata e fton palën kundërshtare ti paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor.
2. Pronari i markës në cilësinë e paditësit, i cili pretendon se shkelja e markës është kryer në veprimtari afariste me qëllim të përfitimit material dhe për këtë paraqet dëshmi gjatë

procedurës: si dokumente bankarë, financiare ose dokumente të tjera afariste apo dëshmi që pohojnë se ato i përkasin palës kundërshtare, gjykata e fton palën kundërshtare të paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor.

3. Kur pala e cila është ftuar të paraqesë dëshmi, mohon se i ka dëshmitë nën kontrollin e saj, gjykata mund të merr veprime për ta pohuar një fakt të tillë.

4. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore lidhur me të drejtën e refuzimit për të paraqitur dëshmi si dëshmitar zbatohen *mutatis mutandis* ndaj së drejtës së palës për të refuzuar paraqitjen e dëshmisë.

5. Gjkata duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit vendos për rëndësinë e faktit që pala e cila i ka dëshmitë, refuzon të veprojë në përputhje me vendimin e gjykatës që e urdhëron atë t'i paraqesë dëshmitë apo mohon në kundërshtim me opinionin e gjykatës.

6. Nuk lejohet apelimi i veçantë kundër vendimit të gjykatës të përmendur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

Neni 104

Procedurat përshpejtuese dhe zbatimi i dispozitave të ligjeve të tjera

1. Procedura në lidhje me shkeljen e markës duhet të jetë e përshpejtuar.
2. Gjatë procedurës në lidhje me shkeljen e të drejtës së markës zbatohen edhe dispozitat e Ligjeve tjera në fuqi.
3. Me kërkesë të gjykatës ose të palës që ka iniciuar procedurën për shkeljen e së drejtës së markës, Zyra pranon kërkesën për anulimin apo shpalljen e pavlefshëm të vendimit për markën e regjistruar, të paraqitur para ose gjatë procedurës dhe do të veprojë në procedurë të shpejtë.
4. Gjkata duke marrë parasysh rrethanat mund të vendos ndërprerjen e procedurës deri te vendimi përfundimtar.

KREU XIV PËRFAQËSIMI

Neni 105

Përfaqësimi nga përfaqësuesit e autorizuar

1. Personat fizikë ose juridik që kanë vendbanimin ose selinë e veprimtarisë në Republikën e Kosovës mund t'i realizojnë të drejtat e tyre sipas këtij ligji edhe përmes përfaqësuesve të autorizuar të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve, që e mban Zyra.

2. Personat fizikë ose juridik të huaj, që nuk kanë vendbanim ose seli të veprimtarisë në Republikën e Kosovë mund t'i realizojnë të drejtat sipas këtij ligji në procedurat në Zyrë vetëm përmes përfaqësuesve të autorizuar të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve që e mban Zyra.

Neni 106

Përfaqësuesit e autorizuar te markave tregtare

1. Përfaqësimi i personave fizikë apo juridikë para Zyrës mund të bëhet nga përfaqësues te autorizuar për marka tregtare të regjistruar me vendim të Zyrës në Regjistrin e përfaqësuesve te autorizuar që mbahet nga Zyra.
2. Zyra e regjistron dhe e çregjistron personin në Regjistrin e përfaqësuesve te autorizuar të Markave Tregtare nëse ai person i plotëson apo nuk plotëson kushtet e përcaktuara më akt nënligjor në përputhje me këtë ligj.

Neni 107

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Përfaqësuesi i autorizuar për marka tregtare mund të përfaqësojë një person fizik apo juridik para Zyrës mbi baza dhe brenda sferës së autorizimit të lëshuar nga personi fizik apo juridik.
2. Autorizimi mund të jepet për një ose më shumë aplikime apo regjistrime të markave tregtare, si për ato ekzistuese ose për të ardhmen.
3. Autorizimi që lidhet me të gjitha aplikimet dhe regjistrimet e markave tregtare të një personi fizik apo juridik njihet si një autorizim i përgjithshëm.
4. Autorizimi mund të jetë i kufizuar për vetëm disa veprime të përcaktuara që ndërmerren pranë Zyrës.
5. Në rast se hiqet dore nga marka tregtare që ka të bëjë me një apo të gjitha mallrat apo shërbimet për të cilat ajo është regjistruar, autorizimi duhet të përmbajë qartë kërkesat e cekura nga pronari i markës tregtare.

Neni 108

Tërheqja e autorizimit

1. Pronari i markës tregtare mund ta tërheqë autorizimin e dhënë për përfaqësuesin e markës tregtare në çdo kohë.
2. Pasi të informohet për ndryshimin e përfaqësuesit, Zyra vazhdon të komunikojë me përfaqësuesin e ri për markat tregtare apo drejtpërdrejt me pronarin e markës tregtare.

3. Pronari i markës tregtare ka dhënë dy apo më shumë autorizime përfaqësuesve të ndryshëm për marka tregtare, është i vlefshëm, autorizimi i cili është me datën më të fundit.

Neni 109 Dorëzimi i autorizimit

1. Përfaqësuesi i markës tregtare që pohon së është i autorizuar për të përfaqësuar pronarin para Zyrës, por nuk i dorëzon Zyrës autorizimin me shkrim për të argumentuar, ftohet që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të ftesës të paraqesë një autorizim të vlefshëm.

2. Me kërkesën e përfaqësuesit për marka tregtare, afati kohor mund të vazhdohet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjerë nga data e skadimit të afatit të cekur në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Nëse përfaqësuesi për marka tregtare nuk i dorëzon Zyrës autorizimin e vlefshëm brenda afatit të paraparë kohor dhe vazhdon të veprojë në emrin e vet, veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi për marka tregtare konsiderohen sikur të mos ishin ndërmarrë fare.

Neni 110 Kompetencat e gjykatës

Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të markës tregtare vendos Gjykata Kompetente

KREU XV DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 111 Dispozitat Ndëshkuese

1. Person juridik që pa autorizim, përdorë një markë tregtare në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji dënohet me gjobë prej pesëmijë (5000) deri pesëmbëdhjetëmijë (15000) Euro.

2. Person fizik që veprojnë në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1500) Euro.

3. Personi përgjegjës i personin juridik që veprojnë në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1500) Euro.

4. Person fizik i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare apo prodhues që vepron në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji dënohet me gjobë prej dymijepesëqind (2500) deri shtatëmijepesëqind (7500) Euro kur shkelja është kryer gjatë zhvillimit të veprimtarive të tij.

5. Produktet e përdorura apo të parapara që të përdoren për kryerjen e shkeljeve të cekura në këtë nen me vendimin e gjykatës kompetente, mund të konfiskohen, shkatërrohen, apo të bëhen të pa përdorura në ndonjë mënyrë tjetër.

6. Në rastet kur marka përdoret në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata varësisht prej shkeljes me të cilin supozohet se është kryer vepër penale, zbaton dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Penal të Kosovës.

KREU XVI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 112

Procedurat e pazgjidhura

1. Të gjitha procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji të cilat janë të pazgjidhura për regjistrimin e markave tregtare, procedurat lidhur me revokimin apo shfuqizimin e markave tregtare dhe procedurat lidhur me aplikimit për regjistrimet e markave tregtare të rivaliduara bëhen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Dispozitat e Kreut X të këtij ligji hyn në fuqi në ditën kur Marrëveshja e Madridit dhe/apo Protokollin e Madridit nënshkruhen nga Republika e Kosovës dhe KREU XI hyn në fuqi pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

3. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, do të nxjerr akte nënligjore në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 113

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/ L-54 “Për Markat Tregtare” si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 114
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-026
29 korrik 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI